R E P U B L I K A E SH Q I P Ë R I S E
BASHKIA VLORE
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Vlore , më..... 2026

DETYRË PROJEKTIMI

PËR OBJEKTIN;

STUDIM PROJEKTIM: REHABILITIM RRJETIT TË K U B

V A D I T E S E D H E K U L L U E S E

Q Y T E T I V L O R E

Përmbajtje

I. DETYRA E PROJEKTIMIT.....

II. OBJEKTIVI.....

III. QELLIMI I PUNES 5
IV. TE DHENAT PER PROJEKTIM 5
V. KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDHE PROJEKTI 5
VI. DETYRAT E PËRGJEGJËSITË E KONSULENTIT 7
VII. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT 10
VIII. MËNYRA E PAGESËS 11

I. DETYRA E PROJEKTIMIT

OBJEKTI: STUDIM PROJEKTIM : REHABILITIM RRJETIT TË KUB VADITESE DHE KULLUESE NE QYTETIN VLORE

Kjo detyre projektimi eshte hartuar dhe ne baze te Udhëzimit Nr. 8, datë 11.10.2024 "Për Miratimin E Metodologjisë, Kritereve Dhe Procedurat, Për Vlerësimin Dhe Prioritizimin E Fondeve Buxhetore Të Investimeve Publike, Për Ofruesit E Shërbimeve Në Sektorin E Ujësjellës-Kanalizimeve".

QELLIMI I PUNËS

Ky projekt do të fokusohet në rritjen e aksesit në ofrimin e shërbimeve mes kanaleve kulluese dhe vaditese..

Trajtimi , disiplinimi I ujrave te larta(te bardha te qytetit per evidentimin e daljes nga shtrati I kanaleve ekzisues si dhe krijimin e nje mjedisi te pershtatshem urban ne zonat ku keto kanale kalojne aktualisht

Projekti i rrjetit te K.U.B synon ne :

- Ne rikonstruktimin e kanaleve kulluese dhe vaditese ;

Me konkretisht ne terma teknik projekti ka si qellim :

- Ne rikonstruksionin e kanaleve kulluse dhe vaditese ne studim projektim parashikuar kjo edhe per 50 vite.
- Sigurimi i nje skeme te projektuar per operim me eficence te larte ;
- Projektimi i rrjetit te K.U.B per te siguruar shkarkimet per secilin nga konsumatoret sipas Standarteve Shqiptare dhe udhezimeve te EU;

TE DHENAT KRYESORE:

Hartimi i projektit të objektit: **REHABILITIM RRJETIT TË KUB (kulluese te larta te qytetit)** sipas VKM Nr. 354 date 11.05.2016.,bazyar ne programet e investimeveper vitin 2026-2027 te Bashkise Vlore

Ky projekt parashikon rehabilitimin e e rrjetit te kanaleve te ujrave te bardhate lokalizuara kryesisht ne pjesen perendimore te qytetit

PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES EKZISTUESE:

Rrjeti i Kanaleve kulluese dhe vaditese

Qyteti i Vlores :

Ne Qytetin e i Vlores jane evidentuar segmente te rjetit kullues dhe vadites problematika te theksuara teknike dhe amortrizim strukturor dhe kapacitet te rreduktuar kullues , duke rritur riskun e permbytjeve gjate periudhave te rreshjeve intensive ne segmentet si me poshte

Qyteti ka aktualisht nje rrjet te kanalizimeve te ujrave te bardha , te ndertuar dhe te vena ne shfrytezim nga Ndermarja e Bonifikimit ne tyrajte kanalesh siperfqsore te pa veshur , te ndertuara gjate periudhes se ekonomise se centralizuar (para viteve 90) te cilat mbledhin ujrat e zones

kodrinore ne vendlindje te qytetit , si dhe ujrat e shiut , keto te findit nje pjese qe grumbullon ne hidrovorin e qytetit dhe nje pjese tjeter shkarkojne direkt ne det
Duhet thene se per nje kohe ky rrjet eshte stabilizuar dhe vene ne funksion , roli I tij ka qene plotesisht e justifikuar nga aktivitete qe kryenta , pra mbledhja e ujrave te bardha dhe disiplinimi I tyre kryhej ne menyre relativisht efektive
Por me kalimin e viteve, ne kushtet kur mirembajtja ka kostot e veta dhe gjithashtu pasojat direkte dhe indirekte te te qenit te pa veshur te kanaleve (mbirja dhe rritja e bimesive te ndryshme te tipit shkure apo kallamishte , grumbullimi I papastertive qe hidhen ne kanal nga qytetar te pa pergjegjshem etj), shpie ne domosdoshmerine qe te behet veshja e ketyre kanaleve ne menyre qe te permiresohen treguesit hidraulike te rrjedhjes

Rrjeti I siperpermendur qe mendohet te rehabilitohet perbehet nga

Kanali I Naunkes
Kanali I paraburgimit
Kanali I fushes majtas
Kanali I fushes djathtas
Kanali nga rruga Dervish Hekali deri te portat e Lagunes
Portat e Lagunes
Kanali postat e lagunes hidrovor
Shkarkuesit katastrofik te rezeervuareve
Rruget e sherbimit te rezervuareve
Perroi I shkolles Tregetare

II. OBJEKTIVI

Objektivi i detyres së projektimit është hartimi i projektit të **"REHABILITIM RRJETIT TË KUB(kanale kulluese)" ne qytetin e Vlores** .

- Përshkrimi në mënyrë të detajuar i punës, analizave dhe konkluzioni për të gjitha fazat e hartimit dhe zbatimit të projektit.
- Do të pasqyrohen të gjitha llogaritjet hidraulike .
- Modelimet e bëra për rastet e funksionimit të rrjetit në momentet e pikut maksimal dhe minimal.
- Gjithashtu do të jepen përshkrime për fazat e ndërhyrjes në projekt, specifikimet teknike si dhe materialet dhe specifikimet e atyre që do të përdoren.
- Te ulen maksimalisht sforcimet ne sistemin e dergimit neperjmjet shtimit, ridimensionimit, zevendesimit dhe plotesimit te nyjeve dhe linjave ku ato jane te vogla.
- Te arrihet qendrueshmeria e projektit ne aspektin mjedisor, social dhe ekonomik.

III. QELLIMI I PUNES

Per rrjetin e K.U.B duhet te parashikohet ndertimi i linjave te reja si dhe stacioneve te pompimit kur eshte e nevojshme.

IV. TE DHENAT PER PROJEKTIM punimi per zbatimin e projekteve duhet te jene me lote si me poshte :

Loti I
Kanali paraburgimit
Kanali I fushes majtas
Kanali I fushes dhjathtas

Vlera e parashikuar : 4.500.000 lekë

Loti I dyte
Kanali I Naunkes
Perroi I shkolles tregetare

Vlera e parashikuar : 7.000.000 lekë

Loti I III
Kanali nga rruga Dervish Hekali deri te portt eLAgunes
Portat e Lagunes
Kanali nga portat deri ne hidrovor

Vlera e parashikuar : 4.500.000 lekë

Loti I IV
Rruget e sherbimit te rezervuareve
Shkarkuesit katastrofik

Vlera e parashikuar : 4.000.000 lekë

PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA

Loti i pare:
Kanali paraburgimit

Gjatësia 500 ml
Duhet pastruar pjesa paralel me murin e burgut dhe pastrim .
Neper hyrjet e shtëpive të trajtohen me tombino ose ura të vogla.
Seksioni aktual ështëB= 1.5-3 m dhe lartësi h=1.5--2 m m.
Eshte I paveshur dhe I mbuluar pjeserisht me bimesi

Kanali i fushës majtas

Gjatësia 1500 ml seksioni H= 2--3 m, B = 8 m
Ky kanal kalon ne zonë te banuar ku ka mure, gardhe, oborre shtëpishë të cilat duhen prishur për pastrimin dhe sistemimin e kanalit
Paraqitet pergjithesisht ne skarpata te mbuluara me bimesi te tipit shkurre , si dh
Në rrugën Lef Sallata ku intersektohet kanali duhet zëvendesuar tombino.
Seksioni i këtij kanali varion nga 1.5-3 m dhe thellësia nga 1-2.5 m.

Kanali i fushës djathtas:

Gjatësia 940 ml duhet pastruar dhe të shikohet mundësia për kalim të këmbësorëve dhe të makinave me urë, pasi është një kanal me seksion 8 m gjerësi dhe 2.5-3 m lartësi.
Pjesa nga ish- karburant Karafilat deri në kanalin e fushes prej një gjatësi 200 ml kalon nëpërmjet shtëpive në të cilat është zvogëluar dimensioni i kanalit
Ndërkohë ka shumë gardhe në të dy anët e kanalit të cilat duhet të prishen per te realizuar pastrimin. H2--3 m, B 3-

Loti i dyte:

Kanali i Naunkes

Gjatesia 1300 ml seksisioni h= 1.5--3 m, B= 3-6 m
Ka nje pjese fillestare prej 50 m te mbuluar me soletine betoni
Ky kanal kalon neper lagje oborre te banoreve , te cilet ne shumicen e rasteve kane zvogeluar seksionin e kanalit duke vendosur tubo fi 800 ,600 mm
Fakti qe keto tombino jane vendosur jo ne kuoten e projektit ka bere qe seksioni I punes se kanalit te zvogelohet duk humbur kapacitetin e plote , gje qe duhet te studiohet nga projekti per dhenien e zgjidhjeve te duhura dhe eknikisht te pershtatshme
Tek hekurudha ky kanal si rezultat I germimeve te here pas hereshmeka pesuar demtime te shpatullave te tombinos duke zene dhe seksionin e tubosdhe eshte rezik per demtimin e e hekurudhes
Duhet bere sistemimmi I kanalit duke veshur me beton

Perroi i shkolles tregetare

Gjatesia 550 ml
Peroi kalon ne zone te banuar
Paraqitet aktiv gjate pothuaj te gjithe vitit dhe eshte relativisht I rrembyeshem per shka te pjerresise (rreth 14.5%) cka mund te kerkoje implementimine masave te ndrushme hidroteknike dhe inxhinjerike ne pergjithesi
Tek ura prane ish kampit te punetoreve duhet te pastrohet dhe duhet të shtohen shuarës energjie (penda deri ne fillimin e trajtimit të projektit).
Ne drejtim te rrjedhjes se kanalit sa kalon uren jane ndertuar objkete te cilat kane ndryshuar dimensionit e kanalit
Tek lokali prane ispostes Uji I ftohet duhet te pastrohet kanali
Nene rrugen tek posta uji ftohte duhet pastruar kanali
Pjesa e kanalit prane shtepise Toto duhet pastruar kanali
Problemarika me e madhe eshte tek fusha e basketbollin nen te cilen kalon kanali dhe derdhet ne det duhet te hiqet betoni dhe te ndertohen siletina sepse ajo pjese eshte bllokuar me material
Permasat e ketjn segmetii nuk te lejon te behet pastrimi pasi lartesia eshte 1.2 m

Loti i trete
Kanali nga rruga Dervish Hekali deri te porta e Lagunes

Ky kanal ze fill ne lindje te rrethrotullimit te autostrades prane karburant Kastrati
Gjatesia 2410m**l** h= 1.5-2 m , B= 3--6 m
Kanali duhet pastruar nga nen kalimi I rruges se burgut deri tek portat e Lagunes.
Pjesa e kanalit nga rruga Dervish Hekali deri tek ura e ish ndermarrja bonifikim
Nderkohe ne kete pjese te kanalit jane ndertuar rreth 25 ura kalimi mbi kanal të cilat duhet të prishen de të ndëtohen ura sipas seksionit per kalim drejt shtepive te banuara .
Per kete duhet nderhyrje per te prure perseri dimensionet e kanalit
Paraqitet pergjithesisht me skarpata here-here te zhveshura dhe here-here te mbuluara me bimesi te tipit shkurre
Gjithashtu nee uren prane ktheses se Nartes duhet bere pastrimi nen ure sepse eshte bllkuar nga mbeturinat te ndryshmeseose ka dhe intercektime me tubacione uji shi dhë te linjave elektrike

Portat e Lagunes



Jane nje veper hodroteknike sume e rendesishme
Paraqitet ne trajten e nje sistemi prej 5 portash me B=1.6 m dhe H=2m dhe si strukture rezulton ne gjendje te mire , por nderkohe portat jane teresisht te amortizyuara , per te mos thene jo ekzistuese
Eshte nje ndertim I viteve 1980 dhe ka nevoje per nje studim te elementeve hidraulik ne kushtet aktuale per te cilat shfrytezohet sot ne menyre qe te percaktohen me saktesi parametrat e postave metalike qe do te perdoren (dimensionet , spesori ,etj)si dhe mekanizmi qe do te aplikohet per venien e ture ne levizje

Kanali nga portat deri ne hidrovor

Gjatesia e kanalit 3100 m B=8-10m, H= 2.5-3 m
Ky kanal paraqitet ne trajten e nje kanali kullues ne mes te parcelave fushore te zones midis Nartes dhe veriperendimit te Vlores
Kanali duhet pastruar
Pjesa e kanalit nen rrugen e hidrovorit duhet pastruar ne te dy anet si dhe vaska e mbritjes se ujave para hekurudhes duhet pastruar

Loti I IV
Rruget e sherbimit te rezervuareve
Rruga e sherbimit rezervuari Bunavise duhet skarrifikuar dhe shtruar me cakell
Rruga e rezervuarit te cerkovines duhet skarrifikuar dhe shtruar me cakell
Rruga e rezeervuarit kanina 1 duhet skarrifikuar dhe shtruar me cakell
Rruga e rezeervuarit te kallafetit duhet skarifikuar dhe shtruar me cakell

Shkarkuesit katastrofik
Shkerkuesi katastrofik e rezervuarit te Babices duhet ndertuar pasi eshte prishur nga ndertimi I rruges mbi priten e rezervuarit
Shkarkuesi katastrofik I rezervuarit te Cerkovinees duhet riparuar
Shkarkuaesi I rezervuarit te Bunavise duhet riparuar
Shkarkuesi katastrofik I rezervuarit te kanina 1 duhet ndertuar pasi eshte prishur

KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDHE PROJEKTI

Permiresim te parametrave hidroteknik te kanaleve te bardha dhe te larta duke patur reference prurjet e ketyre te fundit ne periudha plotash , sipas rilevimeve te bera

Ne mbeshtetje te skemes ekzistuese Operatori Ekonomik “OE” duhet qe pasi te njihet me skemen ekzistuese do te veproje ne plotesimin e saj me eficence.

Kerkohet te percaktohen prurjet e nevojshme per secilin nga zonat e projektit ne menyre qe te pergatitet edhe skema per rrjetin e kanalizimeve te ujrave te ndotura.

Perveç saktesise se te dhenave si me siper, projektuesi, perpara se te filloje punen per projektimin duhet qe paraprakisht:

Dimensionet e kolektoreve per sistemimin e seksioneve te tyre

Konceptimi dhe argymentimi teknik te veprave te artit qe do te ndertohen (ura kalimi , tombina)

Dhenia e zgjidhjeve teknike ne ato raste kur shtreterit egzistues te kanaleve paraqesin problematika te ndryshme hidraulike

1-Te beje relievin (azhornimin) e te gjithe zones ne studim, te jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
2-Te marre te gjitha azhornimet e rrjetit te infrastruktures (ne bashkepunim me institucionet perkatese);
3-Konsulenti duhet te beje verifikimin paraprak ne terren dhe sondime per saktesine e te dhenave/ azhornimeve, per rrjetin e infrastruktures, perpara fillimit te projektimit. Kjo duhet ne menyre qe te evitohen pasaktesite gjate projektimit dhe zbatimit, si rezultat i te dhenave te marra qe nuk perputhen me gjendjen ne terren;

Ne baze sa me siper, kerkohet qe operatori fitues te organizoje punen e tij projektuese ne disa faza.

Mbasi te perfundojne azhornimet ne terren, verifikimet si dhe studimet e nevojshme, per te gjithe zonen qe perfshihet ne projekt, projektuesi ben nje analize te shkurter te situates dhe konsultohet me Ndermarrjen e Sherbimeve Publike Vlore, ku merr edhe te dhenat e para mbi ecurine e planeve/studimeve dhe ndikimin e tyre ne projektin e tij.

Projektuesi harton paraprakisht:

Skemen e rrjetit te kullimit te UB e cila shoqerohet me:

a) Relacion teknik;
b) Nje analize te situates ekzistuese, ne raport me efektet sociale qe mund te sjelle projekti ne drejtim te nderhyrjeve te mundshme dhe te elementeve te kosto-efektivitetit dhe te impaktit social, ekonomik, funksionar dhe mjedisor te nderhyrjes.

Qellimi i kesaj faze eshte qe Projekti te kete analize te perputhshmerise me planet, eficencen ekonomike te nderhyrjes, pra efektivitet te kostos, minimizim te impakteve negative sociale (si p.sh te prishjeve te panevojshme per kete faze etj.)

c) Hartimi i preventivit:

Llogaritja e preventivit do te behet sipas normave dhe akteve ligjore ne fuqi per te siguruar kursimin dhe eficencen e perdorimit te fondeve.

d) Standartet dhe normat e projektimit;

Standarte ne projektim,

Projekti do te hartohet ne perputhje me te gjitha normat dhe standartet per projektimin qe parashikon legjislacioni ne fuqi. Projektimi duhet te siguroje respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjate zbatimit. Eshte pergjegjesi e projektuesit saktesia dhe respektimi i standarteve dhe normave perkatese.

Projektuesi duhet te rekomandoje dhe prezantimin e standarteve te reja, per perafrimin me normat e BE-se, si edhe te praktikave me te mira nderkombetare ne projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet te permbajne elemente te realizueshmerise me praktiken shqiptare dhe limitimet per financimin e vepres.

Standarte ne paraqitjen e dokumentacionit teknik

Ne hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit te projektit, projektuesi te perdore programet e kerkuara kompjuterike, si dhe te nxitet perdorimi i programeve te reja, me te avancuara te fushes.

Ne hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik te projektit te kihet parasysh dhe te respektohen te gjitha kerkesat dokumentare dhe te paraqitjes qe parashikon Ligji "Per urbanistiken", Rregullorja e Urbanistikes dhe Legjislacioni ne fuqi.

DETYRAT E PËRGJEGJËSITË

Në realizimin e objektivave për Projekttet ne fjale, projektuesi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet të përgatisë sipas nenit 37, të VKM.354, dt 11.05.2016 *"Shërbimet për planifikimin e objekteve ndërtimore inixhinierike dhe të komunikacionit"* sipas fazave të mëposhtme:

1. ***FAZA II - PROJEKT IDE PARAPRAKE***
2. ***FAZA III - PROJEKT-IDEJA PËRFUNDIMTARE***
3. ***FAZA V - PROJEKTIN E ZBATIMIT***
4. ***FAZA VI - PREVENTIVIN PËRFUNDIMTAR***

DETYRAT E DETAJUARA PER KETO TERMA REFERENCE JANE SIPAS FAZAVE

1. FAZA II

Pergatitja e raportit te projekt idese paraprake dhe vizatimet e konceptit ne lidhje me skemen e KUB

Ne kete faze, konsulenti do te pergatise:

- Studimin e topografise i cili perfshine rilevimin e zones,
- Studimin gjeologo - inxhinierik .
- Raportin e projekt idese ne lidhje me konceptin dhe gjetjet ne terren;
- Preventivin fillestar

2. FAZA III,

Projekt ideja përfundimtare duhet të përfshijë minimalisht:

- Raportin teknik te projekt idese perfudimtare, ku perfshihen llogaritjet, studimet, analizat e zgjidhjeve te dhena dhe etj
- Vizatimet e zgjidhjes perfundimtare sipas sipas variantit te propozuar, ku te perfshine minimalisht:
    - Horografia planimetria (1:10’000 ose 1:25’000);
    - Ortophoto planimetria (1:10’000 ose 1:5000);
    - Planimetria e linje e K.U.B, (bazuar mbi gjendjen ekzistuese ortophot dhe rilevimin topografik), (1:1’000);
    - Skema primare e K.U.B;
    - Profili gjatesor i linjes kryesore (1:1000H, 1:200V);
- Preventivin;
- Të bëjë një prezantim të projektit përpara Autoritetit Kontraktor

3. FAZA V + FAZA VI,

Projekti i zbatimit dhe preventivi perfundimtar

Projekti i zbatimit duhet të përmbajë:

- **Vizatimet**
    - Horografia planimetria (1:10’000 ose 1:25’000);
    - Ortophoto planimetria (1:10’000 ose 1:5’000);
    - Planimetria e linjes K.U.B, (bazuar mbi gjendjen ekzistuese dhe rilevimin topografik), (1:1000);
    - Skema primare e K.U.B;
    - Profili gjatesor te linjave kryesore (1:1000H, 1:1000V);

- Detaje te intersektimeve dhe kalimeve (Tombino, Ura, Kanale, linja elektrike nentokesore ne shkalle te ndryshme;
- Detaje te pusetave

- **Relacioni teknik dhe llogaritjet përkatëse ne anekse;**

Në raportin teknik përfshihet gjithë informacioni në lidhje me projektin. Në të përshkruhet analiza e kryer nga projektuesit për gjendjen dhe projektimin e saktë të propozuar, jepen të dhëna të sakta, bazuar në gjendjen egzistuese, jepen,

llogaritja e veprave te artit, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, volumet etj. Në raportin teknik do të përfshihen raporti përfundimtar i studimit topografik, studimit gjeologjik, i studimit gjeoteknik dhe investigimit të materialeve, raporti hidrogjeologjik e hidraulik, etj.

- **Specifikimet teknike;**

Projektuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të jepet:

- Përshkrimi i detajuar i zërit të punës, materialet, cilësia e tyre, etj
- Metoda e kryerjes së punimeve;
- Cilësia e kërkuar e punimeve;
- Formatet e lejuara;
- Ngjyra e rekomanduar;
- Njësia e matjes, Etj.

Projektuesi duhet të ketë parasysh se për të gjitha specifikimet e materialeve nuk duhet të përcaktojë emrin e kompanisë qe i prodhon.

- **Preventivi i punimeve (me dhe pa çmime) si dhe Analizat përkatëse te çmimeve;**
  - Preventivi për zbatimin e projektit :
  - Analizë teknike e çmimeve për të gjitha punimet e vlerësuara në preventivë .
  - Zërat e punimeve që nuk janë të përfshira në manualin teknik të çmimeve në fuqi, duhet të shoqërohen me zbërthimin e çmimit (analizën përkatëse) dhe t'i bashkëngjiten vlerësimit.
  - Vlera e preventivit përfundimtar nuk duhet të tejkalojë vlerën e përllogaritur të investimit;

- Preventivi te shoqërohet me tabelat e volumeve.

- **Grafik punimesh;**
  - Grafiku i punimeve të hartohet bazuar në zërat e punës dhe teknologjinë e punimeve të shprehura në Preventiv'

- **Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM)**
  - Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr.10440, datë 07.07.2011,VKM 686 29.07.2015 dhe akteve nënligjore përkatëse